



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2014
Nr. Dok. 201302840/15

Lënda: *Rekomandohet dhënia e gradës së nënkolonelit ushtarakut të dalë në lirim Major L. T. dhe rikthimi i tij në shërbimin aktiv*

Drejtuar: **Ministres së Mbrojtjes**
Zj. Mimi KODHELI

TIRANË

E nderuar Zj. Kodheli,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi L. T., ushtarak i FA i dalë në lirim, i cili pretendon se i është mohuar e drejta për të marrë gradën e nënkolonelit. Më konkretisht ankuesi shpjegon se, në vitin 2008 i është nënshtruar testimit për të përparuar në gradën e nënkolonelit. Në listën e fituesve të Komisionit të Lartë të Karrierës ka arritur të renditet i 22-ti, renditje kjo që i jepte mundësinë të merrte gradën e nënkolonelit pasi numri total i kuatave për përparimin në këtë gradë ka qenë 55 (Urdhëri nr. 958/1 datë 01.09.2008 i Ministrit të Mbrojtjes Z. Gazmend Oketa). Sipas ankuesit, në kundërshtim me vendimin e Komisionit të Lartë të Karrierës dhe me Ligjin nr. 9171 datë 22.01.2004 "*Për Gradat dhe Karrierën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë*", ai nuk është përfshirë në urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes për dhënien e gradës së nënkolonelit.

Për verifikimin e kësaj ankese, nga ana jonë iu kërkua Ministrisë së Mbrojtjes të na vinte në dispozicion fotokopje të dokumentave si më poshtë vijon:

- Lista e Komisionit të Lartë të Karrierës ku renditen ushtarakët e vlerësuar për marrjen e gradës të nënkolonelit në vitin 2008.
- Propozimi i Komisionit të Lartë të Karrierës për dhënien e gradës nënkolonel për vitin 2008 (neni 13/4 i Ligjit Nr.9171, datë 22.01.2004).

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se, L. T. është renditur i 22-ti në listën e të përzgjedhurve për të avancuar nga grada Major në Nënkolonel. Me këtë renditje L. T. duhet të kishte marrë gradën e nënkolonelit pasi ishte brenda kuotës të vendosur nga Shtabi i Përgjithshëm i FA dhe nga Ministri i Mbrojtjes. Megjithatë, L. T. nuk i është dhënë grada e nënkolonelit.

Kujtojmë se, L.T. është ankuar në Avokatin e Popullit që në vitin 2009. Në atë kohë, Avokati i Popullit ka kërkuar disa herë shpjegime për arsyen e mos dhënies së gradës nënkolonel por, për një kohë të gjatë, Ministria e Mbrojtjes nuk ka kthyer përgjigje. Në përgjigjen e vetme që kemi marrë, thuhet

se: "arsyet e mosdhënies së gradës për Zotin T., janë të panjohura nga ana jonë".

Zj. Ministre, nga hetimi i rastit në fjalë del e qartë se, shtetasit L. T., në kundërshtim me ligjin, i është mohuar e drejta për të marrë gradën e nënkolonelit. Mos përparimi në gradën e nënkolonelit ka bërë që, L. T. të dalë në lirim në vitin 2009, pasi kishte plotësuar kohën maksimale të qëndrimit në shërbim për gradën e majorit duke i sjellë atij edhe dëm financiar.

Bashkëlidhur Rekomandimit do të gjeni fotokopje të dokumentave si më poshtë vijon:

- Urdhëri nr. 958/1 datë 01.09.2008 i Ministrit të Mbrojtjes Z. Gazmend Oketa "Për miratimin e kuotave të gradimit të oficerëve për vitin 2008";
- Shkresa Nr.4724 Prot., datë 02.08.2008 i Shtabit të Përgjithshëm "Propozim për kuotat e gradimit për vitin 2008";
- Renditja e të përzgjedhurve për avancimin nga grada Major në Nënkolonel;
- Shkresa Nr.6956/1, datë 25.09.2009 i Drejtorisë së Personel Organizimit "Kthim përgjigje Avokatit të Popullit".

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive."

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Dhënien e gradës së nënkolonelit ushtarakut të dalë në lirim Major L. T. dhe rikthimin e tij në shërbimin aktiv.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi si dhe na dërgoni fotokopje të konstatimeve të mjekut specialist dhe rekomandimeve të tij.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në Mungesë dhe me Porosi

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI